



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2875/5 prot.,

Datë 22.10.2025

V E N D I M
Nr. 1509/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.10.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me numër ankimi elektronik A/2025/5942, datë 25.10.2025 dhe me Nr. 2875/2025 Prot., datë 26.10.2025 e operatori ekonomik “ANADEA” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë E hapur e thjeshtuar” mallra.”, me Nr. REF- REF-60669-09-09-2025, me objekt: “Blerje Autokulle me kosh”, me fond limit 3.570.000 (tre milion e pesëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 22.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve Urbane.

Ankimues: Operatori ekonomik “ANADEA” SHPK me Nipt L87201401H dhe adresë: Njësia Administrative Shupenzë, Bashka Bulqizë, Lagjja Qender, Rruga Nacionale Peshkopi – Tiranë, Bulqizë

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Parqeve Urbane
Lagja 17 "Rruga Dalip Peza", Durrës

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i

Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Përmiratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.09.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit prokurimit “Procedurë E hapur e thjeshtuar” mallra.”, me Nr. REF- REF-60669-09-09-2025, me objekt: “Blerje Autokulle me kosh”, me fond limit 3.570.000 (tre milion e pesëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 22.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve Urbane.

II.2. Në datën 22.09.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 30.09.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. "ANADEA" sh.p.k	3.300.000 lekë	s'kualifikuar
2. ANDI HAMO	3.450.000 lekë	kualifikuar
3. "ARTEO 2018" SHPK	3.450.000 lekë	kualifikuar
4. "Pastrime Silvio " SH.P.K	3.119.000 lekë	s'kualifikuar

II.4. Në datën 30.09.2025 operatori ekonomik "ANADEA" sh.p.k është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

" - - Oferta refuzohet sepse nuk ploteson kërkesat e DT per kontratat e ngjashme sipas pikes 2.3 te shtojces 8 per kapacitetin teknik.Faturat nuk ngjasojne me natyren e objektit te prokurimit.."

II.5. Në datën 10.10.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik "Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak" për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi..

II.6. Në datën 16.10.2025 dhe datë 10.09.2025, pranë Komisionit të Prokurimit Publik është dorëzuar ankesa me numër ankimimi A/2025/5942, datë 21.10.2025 dhe me Nr. 2875/2025 Prot., datë 16.10.2025 e operatori ekonomik "ANADEA" SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij, nga procedura e prokurimit të sipërcituar me argumentimin si vijon:

"Me këtë ankesë, ANADEA shpk kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO), i cili ka skualifikuar ofertën tonë duke pretenduar se nuk plotësohen kërkesat e DST-së për kontratat e ngjashme sipas pikës 2.3 të shtojcës 8 për kapacitetin teknik, dhe se faturat e paraqitura nuk janë të pranueshme. Ky vlerësim është i pabazuar në ligj dhe në kundërshtim me dokumentet e tenderit.

1. Fatura e paraqitur është dokument i vlefshëm ligjërish për përvojë të ngjashme.

Sipas pikës 2.3.1(b) të DST-së, për përvojat e mëparshme me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. ANADEA shpk ka paraqitur faturën nr. 12/2024, datë 23.02.2024, të lëshuar ndaj Makhes Group, me vlerë 18,000 EUR, të deklaruar në Platformën Qendrore të Tatimeve dhe të vlefshme në çdo aspekt ligjor.

2. KVO ka tejkaluar kriteret e përcaktuara në DST.

DST nuk kërkon kontratë apo procesverbal dorëzimi, por mjafton fatura tatimore e deklaruar. Refuzimi i këtij dokumenti bie në kundërshtim me nenin 52 të Ligjit nr. 162/2020, i cili ndalon interpretimin subjektiv apo shtimin e kërkesave nga KVO.

3. Mungesë e kërkesës për sqarim nga autoriteti.

Në kundërshtim me nenin 51 të VKM nr. 285/2023, KVO nuk ka kërkuar asnjë sqarim apo dokument shtesë për faturën e paraqitur, duke cenuar parimin e transparencës dhe të drejtën e mbrojtjes së operatorit.

4. Furnizimi është i ngjashëm në natyrë dhe vlerë me objektin e kontratës.

Fatura e paraqitur përfshin shitjen e një automjeti të specializuar IVECO Daily, i cili përbën furnizim të të njëjtës natyrë teknike me autokullën me kosh, dhe vlera e tij përbën më shumë se 20% të fondit limit të kontratës.

III. Kërkesa

Në bazë të sa më sipër, ANADEA shpk kërkon:

- Rishikimin e vendimit të KVO-së;*
- Pranimin e faturës tatimore nr. 12/2024 si dëshmi të vlefshme të përvojës së mëparshme të ngjashme;*
- Rivlerësimin e ofertës sonë në përputhje me DST-në dhe ligjin në fuqi.”*

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 2875/1 prot., datë 16.10.2025, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “ANADEA” SH.P.K kundërshton me anë të ankesës me nr. 2875 prot, datë 16.10.2025.

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga operatorë ekonomikë, në cilësinë e subjektit të interesuar, në përputhje me nenin 113 të LPP-së i ndryshuar.

II.9. Më datë 22.10.2025 operatori ekonomik “ANADEA” SH.P.K ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike shkresën e datës 21.10.2025 me lëndë “Tërheqje nga ankimi për procedurën e prokurimit me Nr. REF- REF-60669-09-09-2025, zhvilluar nga, Agjencia e Parqeve Urbane” protokolluar me tonën me nr. 2875/2 dhe nr.2421/5 prot., datë 22.10.2025, me anë të së cilave kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me kërkesën e operatori ekonomik “ANADEA” SH.P.K, për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “Procedurë E hapur e thjeshtuar” mallra.”, me Nr. REF- REF-60669-09-09-2025, me objekt: “Blerje Autokulle me kosh”, me fond limit 3.570.000 (tre milion e pesëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 22.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve Urbane, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet:
*“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.
2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”*

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës me numër ankimi elektronik nr. ankimi elektronik A/2025/5942, datë 21.10.2025 dhe me Nr. 2875/2025 Prot., datë 16.10.2025, të operatorit ekonomik “ANADEA” SH.P.K për procedurën e prokurimit objekt-ankim, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “Procedurë E hapur e thjeshtuar” mallra.”, me Nr. REF- REF-60669-09-09-2025, me objekt: “Blerje Autokulle me kosh”, me fond limit 3.570.000 (tre milion e pesëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 22.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve Urbane.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “ANADEA” SH.P.K.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

